



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1286/Prot

Tiranë, më 01/12 /2016

**Lënda:** *Kthim përgjigje*

**Drejtuar:** **MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT TREGTISË  
DHE SIPËRMARRJES  
AGJENCISË SË TRAJTIMIT TË KONCESIONEVE**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 308 prot, datë 15.11.2016, lidhur me bërjen publike në regjistrin elektronik të koncesionit/ppp, të të dhënave të kontratave të koncesionit/ppp, në përputhje me qëllimin e përcaktuar në VKM nr. 211/2016, "Për Krijimin dhe Administrimin e Regjistrit Elektronik të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat", paraprakisht sqarojmë se Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve si administrues i këtij regjistri ka rolin e kontrolluesit në kuptim të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Në këtë kuptim, realizimi i përpunimit/publikimit të të dhënave duhet të kryhet në përputhje me kërkesat e këtij ligji, ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe Udhëzimit nr.39, datë 05.08.2013 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale në regjistrat publikë".

Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", kontratat e koncesionit dhe të prokurimit publik hyjnë në kategorinë e informacionit i cili bëhet publik pa kërkesë, në kuadër të miratimit dhe publikimit të programit të transparencës së çdo autoriteti publik.

Sa i takon publikimit të dokumentacionit shoqërues të kontratave të koncesionit, kur nga autoritetet publike depozitohen të tilla, vlerësimi nga ana juaj duhet bërë rast pas rasti në raport me kufizimet e parashikuara në nenin 17 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", duke respektuar dhe argumentuar të drejtën e autorit, pronësinë intelektuale, sekretet tregtare dhe ekonomike të pasqyruara, etj..

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

